


REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br.Prot. Prot No.
Nr. l faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	05.05.2015
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP 03-03/822/15
PËR/ZA/TO:	z. Faredin SYLEJMANI Menaxher i Zyrës së Prokurimit - Spitali Rajonal Gjilan
CC:	z. Abdylatif LATIFI Drejtor Ekzekutiv - Spitali Rajonal Gjilan
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Servisimi dhe Mirëmbajtja e Pajisjeve radiologjike të Apelemit "

I nderuari, z. SYLEJMANI,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin: " Servisimi dhe Mirëmbajtja e Pajisjeve radiologjike të Apelemit " me nr. të prokurimit: 702-15-13-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Servisimi dhe Mirëmbajtja e Pajisjeve radiologjike të Apelemit " me numër prokurimi:702-15-13-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m i

Spitali Rajonal në Gjilan, përmes Zyrës së Prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " Servisimi dhe Mirëmbajtja e Pajisjeve radiologjike të Apelemit " me numër prokurimi: 702-15-13-221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 19.02.2015 në Procedurë të Hapur. Për këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti kontraktues ka paraparë procedurën e hapur, Kontratë të llojit shërbime me vlerë të mesme të kontratës.

Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar dokumentacionin përkatës për këtë aktivitet të prokurimit pasi që Komisioni vlerësues ka përfunduar me procesin e vlerësimit të tenderëve. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit, Agjencia ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej 5 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 2 prej tyre.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve i cili është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Komisioni vlerësues pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se ka 2 oferta ku vetëm njëri nga Operatorët ekonomik është i përgjegjshëm, ndërsa Operatori tjetër ekonomik nuk i plotëson kërkesat e parapara sipas nenit 69 të LPP-së më konkretisht ofertës i mungojnë kontrata, referenca dhe certifikata profesionale për serviser të cilat janë kërkuar në kuadër të rubrikës Kapaciteti teknik profesional të Dosjes së Tenderit.

Në rubrikën vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm theksohet se Zyrtari i Prokurimit pas marrjes së rekomandimit nga ana e Komisionit vlerësues konkludon se tenderi ka vetëm një ofertë të përgjegjshme dhe pas shumë hulumtimeve të bëra në treg dhe viteve paraprake për shërbime të ngjashme konkludon se po të shkohet me ritenderim nuk do të rezultojë me rritjen e numrit të ofertave për shërbime, andaj do të kërkojë ndihmën nga KRPP-së për revokim të dispozitës 4 të nenit 32 dhe aprovim të dispozitës 5 të këtij neni dhe vendosjen me një Operator. Sipas tij Oferta e Operatorit ekonomik Medical plotëson kriteret e parapara sipas nenit 65,66 dhe nenit 69 të LPP-së nr.04/L-042.

Me dt.25.03.2015 Zyrtari i Prokurimit ka paraqitur Njoftimin për përjashtim të kërkesës më pak se dy tender të përgjegjshëm në Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik, ku në këtë njoftim ka paraqitur shpjegimet si në vijim " *Pas hulumtimeve të bëra në treg dhe viteve paraprake edhe tani konsiderojmë se po të shkohet me ri-tenderim nuk do të rezultojë në rritjen e numrit të ofertave të përgjegjshme, andaj kërkojmë anulimin e paragrafit 4 dhe aprovim të paragrafit 5 të nenit 32 të LPP-së dhe dhënien e kontratës me ma pak se dy oferta të përgjegjshme* ".

Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që në rastet kur Autoriteti Kontraktues demonstroi se për Servisimin e Pajisjeve të tilla në treg është vetëm një Operator ekonomik, atëherë duhet që ta caktojë Procedurën adekuate për zhvillimin e aktivitetit përkatës të Prokurimit.

Në kërkesën e njësisë kërkuese përkatësisht Repartit të Radiologjisë tek pjesa e Specifikacionit teknik është paraparë 1. Servisimi dhe Mirëmbajtja e Rentgenit në repartin e Radiologjisë, ku brenda kësaj është paraparë Radiografi, n/s: 407339, Fluroskopia, n/s:035059 Mirëmbajtja me pjesë rezervë e tyre, 2. Servisimi dhe Mirëmbajtja e Rentgenit në DSM ku brenda tij është paraparë radiografi, n/s: 2364 mirëmbajtja me pjesë rezervë, Njësia Kërkuese nuk ka precizuar se cilat pjesë të këtyre aparaturave mjekësore do të ndërrohen me ç'rast kemi një Specifikacion të mangët ku nuk dihet se cilat pjesë do të ndërrohen apo servisohen dhe të njëjtat Specifikime teknike janë paraparë edhe në Dosjen e këtij tenderi.

Agjencia Kundër Korrupsionit gjithashtu ka vërejtur se në vërtetimin tatimor i lëshuar nga Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës figuron se Operatori ekonomik i rekomanduar për këtë kontratë ka borxhe tatimore dhe obligime tjera tatimore të pa shlyera, andaj si i tillë do duhej të shpallej si i pa përgjegjshëm. Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik kërkohet një vërtetim në lidhje me tatimet i lëshuar nga administrata tatimore të vendit të themelimit që OE nuk është me vonesë në pagesën e tatimeve të paktën deri në çerekun e fundit të vitit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit nenin 28 Specifikimet teknike, nenin 32 Rregullat e Përgjithshme të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikën e të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !